

AKTI I THEMELIMIT

I

SHOQERISE TREGTARE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR “GLADIUS” SH.P.K.

Themeluesi qe nenshkruan me poshte eshte si vijon:

Z. YASAR ÇETIN i datelindjes 14.02.2000, atesia Bulent, lindur ne Konak/Turqi dhe banues ne Turqi, Bornova merkez Erzene mahallesi 9 sokak no:3 tekin apartmani daire 19, İzmir, Shtetas turk mbajtes i pasaportes me nr. U25240119 madhor, me zotesi te plote juridike per te vepruar,

Z. CAN OZBILGI i datelindjes 10.09.2000, atesia Mehmet Salih lindur ne Konak/Turqi, banues ne Turqi , Yaka Mahalle, Dikmen Sokak, No:1 Daire:1, Urla/İzmir, shtetas turk, mbajtes i pasaportes me nr. U25239689, madhor, me zotesi te plote juridike per te vepruar,

Qe ne vijim do te quhet Ortaku i Shoqerise “GLADIUS” SH.P.K.

Sot me date **23.06.2023**, bazuar ne vullnetin e tyre te lire dhe ne perputhje me ligjin Nr.9901 date 14.04.2008 “Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare”, vendosen te themelojne Shoqerine Tregtare me Pergjegjesi te Kufizuar, ne baze te kushteve qe vijojne:

Kreu I

OBJEKTI, EMERTIMI, SELIA, REGJIMI JURIDIK

Neni 1

Objekti i shoqerise

Shoqeria Tregtare “GLADIUS” SH.P.K, ka si objekt veprimtarie:

1. Hapja dhe menaxhimi i Lounge bar-lokal-restorant.
2. Shoqeria, mund te kryeje per permbushjen e qellimeve te saj cdo lloj operacioni tregtar, blerje pasuri te luajtshme apo te paluajtshme, t’i marre ose t’i leshoje me qera. Mund te vendose pasuri te luajtshme dhe te paluajtshme, t’a hipotekojte kete pasuri ne rregjistrin e pasurive te paluajtshme ne emer te saj.
3. Mund te hyje ne tratativa dhe biznese me shoqeri te tjera qe kane te njejtin objekt veprimtarie per te realizuar fitime ne fushat e permendura.

Neni 2

Emertimi dhe Selia Juridike e Shoqerise

Ortaket vendosen qe shoqerine t’a emertojne “GLADIUS” SH.P.K.

1. Selia juridike e Shoqerise ndodhet ne Bulevardi Gjergj Fishta, Pll. E88, H.1, Dyqan Nr.24, Tirane



2. Shoqeria mund te krijoje qendra sekondare, filiale, zyra perfaqesimi e agjensi ne qytete te tjera te Shqiperise ose jashte vendit.

Neni 3

Forma Juridike

1. Shoqeria eshte shoqeri me pergjegjesi te kufizuar. Veprimtaria e saj i nenshtrohet dispozitave te Aktit te Themelimit, Statutit dhe legjislacionit shqiptar ne fuqi
2. Me vendim te ORTAKEVE mund te ndryshoje formen juridike te Shoqerise, ne qofte se ne te ardhmen krijohen premisa me te favorshme per funksionimin e saj sipas legjislacionit shqiptar. Ne kete rast Ortaket do te pershtasin Aktin e Themelimit dhe Statutin e shoqerise, si dhe do te bejne regjistrimin e saj ne regjistrin tregtar, ne organet kompetente shqiptare.
3. Shoqeria gezon personalitet juridik nga data e regjistrimit te saj ne regjistrin tregtar nga organet kompetente dhe ne perputhje me ligjin.
4. Shoqeria do te kete vulen e saj.

Kreu II

TE DREJTAT DHE DETYRAT, KOHEZGJATJA

Neni 4

Te drejtat e Shoqerise dhe te Ortakeve

1. Shoqeria ka te drejte te lidhe marreveshje dhe te nenshkruaje kontrata ne territorin e Shqiperise dhe jashte saj.
2. Shoqeria gezon te drejten te krijoje pasuri materiale dhe intelektuale.
3. Shoqeria ka te drejte te marre pjese si ortak ne nje shoqeri tjetere ose ndermarrje te ndryshme ne Shqiperi ose jashte saj, ne perputhje me legjislacionin shqiptar.
4. Shoqeria pergjigjet ndaj te treteve vetem dhe ekskluzivisht me kapitalin e saj shoqeror te derdhur dhe me te mirat e pasurise se saj.
5. Ortaket marrin pjese ne administrimin e veprimtarise se shoqerise ne perputhje me Aktin e Themelimit dhe Statutin, vet ose nepermjet perfaqesuesve te tij.
6. Ortaket kane te drejte te marrin te gjitha informatat qe kane te bejne me veprimtarine prodhuese, projektuese, realizuese e tregtare te shoqerise, si bilancet, llogarite ekonomike etj.

Neni 5

Kohezgjatja

Kohezgjatja e shoqerise eshte me afat te pacaktuar.



Kreu III
KAPITALI THEMELTAR

Neni 6

Kapitali Themeltar

Kapitali themeltar eshte **100.000 (njqind mije) Leke** . E ndare ne 2 (dy) kuota.

Ortaket e shoqerise jane:

YASAR ÇETIN, zotërues i **50% (pesedhjetë) te kuotave** të kapitalit të shoqërisë, gjithsej 50.000 leke;
CAN OZBILGI zotërues i **50% (pesedhjetë) te kuotave** të kapitalit të shoqërisë, gjithsej 50.000 leke;

Kreu IV
PERSONALITETI JURIDIK

Neni 7

Shoqeria fiton personalitetin juridik ne ditën e rregjistrimit te saj ne Rregjistrin Tregtar ne Qendren Kombetare te Rregjistrimit ne Tirane, si dhe fillon veprimtarine e saj me marrjen e licences te ushtrimit se veprimtarise.

Kreu V
ADMINISTRIMI

Neni 8

1. Shoqeria do te administrohet nga administratori **ERDEM DIREK**, e cila perfaqeson shoqerine ne marredheniet me te tretet per nje periudhe **5 (pese)** vjecare dhe me te drejte rizgjedhje.
2. Administratori mund t'i delegeje kompetencat e tij me shkrim ne formen e autorizimit ose me prokure.


Kreu VI
DISPOZITA TE TJERA

Neni 9

1. Fitimi i realizuar nga Shoqeria, pas shlyerjes se detyrimeve ligjore, do t'i mbetet Ortakut te saj, ta ndaje si dividend apo ta shtoje ne kapitalin e shoqerise.
2. Ky Akt shtypet dhe nenshkruhet ne 2 (dy) kopje, te gjitha me te njejten vlere ligjore.
3. Nje kopje qendron ne dokumentacionin baze te shoqerise.

ORTAKET THEMELUES

YASAR ÇETIN

Yasar Çetin


CAN OZBILGI

Can Ozbilgi
